

VENDIM
Nr. 703, datë 6.12.2023

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË KOLEGJIT UNIVERSITAR “PAVARËSIA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “I”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e veprimtarisë së kolegjit universitar “Pavarësia”, i cili e ka ushtruar veprimtarinë në qytetin e Vlorës.

2. Kolegji universitar “Pavarësia” ka këto detyrime:

a) të përgatisë dosjen për çdo student që nuk ka përfunduar programin përkatës të studimit, me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit të lartë, që plotëson kriteret ligjore për transferimin e studimeve dhe t’ia vërë atë në dispozicion vetë studentit, pa asnjë detyrim financiar shtesë nga ana e tij, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

b) të kthejë pagesat e kryera nga studentët për pjesën e papërfunduar të programeve përkatëse të studimit, për rastet kur pagesat janë kryer për cikël studimi, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbyshur që mund të ketë ndaj studentit;

c) të mbyllë të gjitha detyrimet lidhur me veprimtarinë kërkimore-shkencore në të gjitha ciklet e studimit ku ushtron veprimtarinë dhe për të gjitha programet e studimit të ofruara;

ç) të dorëzojë dokumentacionin ligjor, administrativ, financiar dhe akademik që disponon dhe mbi bazën e të cilit ka zhvilluar veprimtarinë e saj akademike dhe kërkimore-shkencore në strukturat përgjegjëse, në përputhje me kuadrin ligjor për arkivat, brenda 2 (dy) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

d) të vendosë në dispozicion të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë vendim;

dh) të marrë masa që të heqë nga objekti i veprimtarisë së personit juridik në institucionin përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të regjistrimit dhe licencimit të biznesit fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

3. Vula e kolegjit universitar “Pavarësia” të asgjësohet sipas procedurave të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi.

4. Të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për mbylljen e kolegjit universitar “Pavarësia”, në zbatim të këtij vendimi, të përballohen nga ana e institucionit jopublik të arsimit të lartë/personit juridik privat që e përfaqëson.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe kolegji universitar “Pavarësia” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku